- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, **një certifikatë e pranimit të përkohshëm**.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkritazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të filloj nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë pune, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimit përfundimtar**, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërprente punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;

f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundoj vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 “**Force Madhore**” siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.

ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.

iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.

iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.

v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41

Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42

Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundur. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES**KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.


[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Përkufizimet	1.3	Sipas kushteve të përgjithshme.
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë: Gjuha Shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është: 10% të vlerës së kontratës , për kohëzgjatjen e periudhës prej: [24 muaj + 30 ditë] , nga data e nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë e tyre, Impianteve dhe Materialeve gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definiuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, sëbashku me materialin dhe impiantin gjer në kosoton e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është: 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar; (d) Ndëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar, (ii) të personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar,
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të Projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë nga dita e caktuar në planin e menaxhimit nga menaxheri i projektit.


	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë: Sipas Dinamikës së punëve dhe arsyeshmeris së vonësive të lejuara nga organi mbyqkyrës. Kontrata është: 24 muaj.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë: 0.25 % e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është: 10 % e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në Vend – Punishte nga ana e Kontraktuesit.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Inspektimi dhe testimi behet konform kushteve te përgjithshme te kontratës. Menaxheri i Projektit caktohet me vendim nga Z.K.A – ja.
Pagesat	24.1	Pagesat do të bëhen në Euro. Autoriteti Kontraktues do ti paguaj kontraktuesit vlerën e kontraktuar në situacionin.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: 10% të vlerës së kontratës = 15,730.62 €, sipas Ligjit Nr. 06/L-133. LIGJI Nr. 06/L-133 PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2019 Neni 13- Pagesat e paradhënies, pika 1. thotë: 1. Organizatat buxhetore mund të paguajnë paradhënie kontraktuesve për projektet kapitale dhe për mallra dhe shërbime deri në pesëmbëdhjetë përqind (15%) të vlerës së kontratës. Pagesa e tillë e paradhënies mund të bëhet vetëm në bazë të kontratës së lidhur në mënyrë ligjore, me vlerë më të lartë se dhjetë mijë (10,000) Euro, e cila është arritur në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik. Për pagesën e paradhënies për projektet kapitale, kontrata duhet të përmbajë garancionin e performansës dhe orarin qartazi të përcaktuar të pagesave, e cila njëkohësisht parasheh punën që duhet kryer para se të bëhet secila pagesë. Orari i pagesës: Në dorëzimin e situacionit të parë, pagesa do ti ndalet në 30 % i shumës së parapaguar: 4,719.18€, Në dorëzimin e situacionit të dytë, pagesa do ti ndalet në 30 % i shumës së parapaguar: 4,719.18 €, Në dorëzimin e situacionit të tretë, pagesa do ti ndalet në 40 % i shumës së parapaguar: 6,292.26 €. Për punët që duhen të kryehen para se të bëhen pagesat.
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% të vlerës së kontratës (me sigurim ekzekutimi).
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësi mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve do të jetë: 24 muaj. Periudha e përgjegjësisë se defekteve do të fillojë në datën e pranimit të punëve.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.

Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Zyra e Prokurimit – Komuna e Rahovecit ose Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – Divizioni i rregullave.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Themelore Prishtinë] në pajtim me ligjin në Kosovë.


Paramasa dhe Paralogaria "Hartimi i Projektit për ndërtimin e Qerdhës në Xërxe"					
A. ARKITEKTURA					
1.1. PUNËT PËRGADITORE					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.1.1	Inqizimi i parcelles në vendin e parapare për ndërtimin e qerdhës, si dhe bartja e pikave nga projekti në terren se bashku me organin mbikqyres.	paush.	1.00	100.00 €	100.00
1.1.2	Punimi i rrethojës së kantierit në pjesën pergjate rruges dhe pjesët anore të parcelles. Rrethoja duhet punuar me material të qëndrueshëm nga llamarinat me lartësi 2 m.	m'	75.00	3.00 €	225.00
1.1.3	Kontrollimi dhe evidentimi i instalimeve nëntoksore, zgjedhja e problemeve eventuale që lidhen me planin operativ të ndërtimit si dhe përpilimi i planit detaj operativ që lidhet me procesin e ndërtimit. Në çmim të llogaritë edhe kosto eventuale e detektimit me aparatura elektroteknike për instalime nëntoksore si dhe evidentimi i sakte i instalimeve që duhet të mirëmbahen gjatë kohës së ndërtimit (rjeti elektrik, rjeti i ujësjellsit, kanalizimit etj.)	paushall	1.00	50.00 €	50.00
1.1.4	Furnizimi me material dhe ndërtimi i rjetit të përkohëshëm të ujësjellsit, kanalizimit, rjetit elektrik dhe ndiqimit të kantierit.	paush.	1.00	100.00 €	100.00
1.1.5	Punimi i objekteve përcjellëse për nevoja të kantierit. Këtu përfshihen hapësira zyrtare e menaxhimit të kantierit, mbikëqyrësin si dhe hapësirat për punëtorë (garderobat dhe trapezaria).	paush.	1.00	100.00 €	100.00
1.1.6	Pastrimi i parcelles nga mbeturinat e mundshme, materiali të largohet në deponi legale.	paush.	1.00	50.00 €	50.00
TOTALI POSICIONI:					625.00
1.2. PUNËT E DHEUT DHE MBUSHJA					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.2.1	Germimi i gjere i dheut të kategorisë III me trashësi t=20cm, për rrafshimin dhe nivelizimin e terrenit. Materiali i germuar largohet në deponi legale.	m³	11.60	1.80 €	20.88
1.2.2	Germimi i dheut të kategorisë së III -të për hapjen e themeleve shiritore të. Largimi i të njëjtit në largësi brenda kantierit për përdorim në rregullimin e oborrit, pjesa e teperet dhe e podobishme largohet në deponi legale.	m³	178.60	1.80 €	321.48
1.2.3	Furnizimi, hudhja dhe ngjeshja e zhavorit 0-62 mm nën themelet përreth cokollesë dhe nën pllaken e dyshemese, mbi dheun e ngjeshur me mekanizim përkatës.	m³	112.00	6.50 €	728.00
1.2.4	Furnizimi, hudhja dhe ngjeshja e zhavorit 0-32 mm në trashësi d= 15.0 cm e ngjeshur me mekanizim përkatës nën pllaken e dysheme se objektit.	m³	33.00	7.50 €	247.50
TOTALI POSICIONI:					1,317.86
1.3. PUNËT E BETONIT					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.3.1	Furnizimi dhe betonimi i shtresës së betonit, me beton të ngjeshur C15 Mpa në trashësi d = 4-6 cm nën themelet. E cila shërben si shtresë mbrojtëse e armatës.	m²	8.20	40.00 €	328.00
1.3.2	Furnizimi dhe betonimi i themeleve shiritore, cokolles dhe pllakes së dyshemes, kalit i dhe pllakes së kulmit. Me beton të armuar C25- 30 Mpa në pahitë përkatëse sipas projektit. Siperfaqja e jashtme e pahive të jete e lëmuar.	m³	264.30	55.00 €	14,536.50
1.3.3	Latimi dhe betonimi i trajeve me beton të armuar C25/30 Mpa	m³	28.40	55.00 €	1,562.00
1.3.4	Latimi dhe betonimi i shtyllave me beton të armuar C25/30 në kallupet përkatëse sipas projektit.	m³	15.30	55.00 €	841.50
TOTALI POSICIONI:					17,268.00
1.4. PUNËT E ARMATËRES					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.4.1	Furnizimi, transporti, prerja si dhe vendosja e ARMATURËS ÇBR-400/500 në tërësi në të gjitha pozicionet sipas llogarisë statike.	kg	24540.52	0.47 €	11,534.04
1.4.1	Furnizimi, transporti, prerja si dhe vendosja e ARMATURËS Q524 në tërësi në të gjitha pozicionet sipas llogarisë statike.	kg	3380.00	0.47 €	1,588.60
TOTALI POSICIONI:					13,122.64




1.5. PUNET E MURATIMIT DHE SUVATIMIT					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.5.1	Furnizimi dhe muratimi i mureve të jashtme dhe të mbrendshme me blloka të argjies d=25cm me llaq vazhdues në perpjesë 1:2:6 në teresi sipas projektit.	m ²	142.00	30.00 €	4,260.00
1.5.2	Furnizimi dhe muratimi i mureve të jashtme dhe të mbrendshme me blloka të argjies d=20cm me llaq vazhdues në perpjesë 1:2:6 në teresi sipas projektit.	m ²	52.00	30.00 €	1,560.00
1.5.3	Furnizimi dhe muratimi i mureve të mbrendshme me blloka të argjies d=12cm, muri me llaq vazhdues në perpjesë 1:2:6 në teresi sipas projektit.	m ²	10.70	18.00 €	192.60
1.5.4	Furnizimi me material dhe suvatimi i mureve të brendshme dhe plafonit. Me llaq gelqeror në përpjesë 1:3 në dy shtresa me finalizim të lëmuar. Në pozicion të parashihet vendosja e kendoreve në këndet e mureve.	m ²	1874.60	3.00 €	5,623.80
TOTALI POSICIONI:					11,636.40
1.6. PUNET E KULMIT					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.6.1	Furnizimi, punimi dhe montimi i konstruksionit të kulmit në objektin. Komplet mbi pllakë nga druri i përpunuar me: Mahite=10/12cm; Nenmahite=12x14cm; Shtyllat=12x14cm Shtangimet=16x14cm; danat=(15x7)x2cm; në tërësi sipas projektit. Llogaria në m2 në sipërfaqe të rrafshet.	m ²	316.80	13.00 €	4,118.40
1.6.2	Furnizimi dhe vendosja e dërrasave t=24 mm mbi konstruksionin kulmit, si bazament për vendosjen e letres difuzive dhe listelave. Llogaria në m ² Llogaria në m2 në sipërfaqe të rrafshet.	m ²	316.80	3.80 €	1,203.84
1.6.3	Furnizimi dhe vendosja e kontra listelave 2/4 cm në çdo 70cm mbi dyshemenë e dërrasave për krijimin e sipërfaqes ajruese. Llogaria në m2	m ²	316.80	0.40 €	126.72
1.6.4	Furnizimi dhe shtrirja e letres difuzive 110gr/m ² mbi sipërfaqen paraprakisht të mveshur me dërrasa të konstruksionit të kulmit, përfshirë të gjitha punet përgatitore. Llogaria për m ² bazës së kulmit Llogaria në m2 në sipërfaqe të rrafshet.	m ²	316.80	0.70 €	221.76
1.6.5	Furnizimi dhe vendosja e listelave 5/8 në çdo 80 cm mbi kontralistela. Llogaria në m2 Llogaria në m2 në sipërfaqe të rrafshet.	m ²	316.80	0.50 €	158.40
TOTALI POSICIONI:					5,829.12
1.7. PUNET E LLAMARINËS					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.7.1	Furnizimi, transporti dhe punimi i mbulesës së kulmit të objektit. Me llamarinë të plastifikuar dhe valëzuar d=0.55mm me brinjë t=4cm - "Tip T50" (100% e mbuleses), përfshirë kulmaret, aksesoret përcjelles për kompletim, dhe me shtresën kundër kondenzit, ngjyrë sipas zgjedhjes së investitorit. Llogaria në m2 në sipërfaqe të rrafshet. Llogaria në m2 në sipërfaqe të rrafshet.	m ²	315.80	5.50 €	1,736.90
1.7.2	Furnizimi, transporti dhe montimi i ullukëve horizontal nga llamarina e plastifikuar t=0.55mm.	m'	87.40	4.10 €	358.34
1.7.3	Furnizimi, transporti dhe montimi i ullukëve vertikal nga llamarina e plastifikuar me dimensione Ø12cm, t=0.55mm	m'	42.00	4.10 €	172.20
1.7.4	Furnizimi transporti dhe montimi i llamarinës së plastifikuar me ngjyrë sipas investitorit për punimin e mveshjeve të oxhakut	cope	1.00	20.00 €	20.00
TOTALI POSICIONI:					2,287.44
1.8. PUNET E HIDROIZOLIMIT DHE TERMOLIZOLIMIT					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.8.1	Furnizimi, transporti dhe punimi i hidroizolimit horizontal me saldim të lidhjeve në pllaken e dyshemes. Hidroizolimi punohet me material hidroizolues shumëstresor - tipi kondor, t=4mm dhe me një shtresë lyerje bituliti. Llogaria në m2.	m ²	241.00	4.50 €	1,084.50
1.8.2	Furnizimi, transporti dhe izolimi i dyshemes dhe mureve në nyjet sanitare. Me izolim dy komponentesh me të gjitha punet përcjelles.	m ²	366.00	3.00 €	1,098.00
1.8.3	Furnizimi, transporti dhe punimi me stiroprit N4 i fasadës së jashtme. Me trashësi t=12 cm sipas projektit. Në çmim të llogaritët ngjites dhe elementet lidhëse-tiplat	m ²	560.00	5.00 €	2,800.00
1.8.4	Furnizimi dhe vendosja e materialit termoizolues (styrodur) me trashësi t=8.0 cm e cila vendoset përreth xokullës së objektit h=60cm.	m ²	35.00	6.50 €	227.50
1.8.5	Furnizimi dhe vendosja e materialit termoizolues me trashësi t=4.0 cm 2x2 e cila vendoset mbi pllaken e perdhesës, Katit dhe pllakes sekulmit, sipas projektit. Në çmim të llogaritët edhe shtresa mbrojtëse e termoizolimit, PVC folie.	m ²	784.30	2.00 €	1,568.60



TOTALI POSICIONI:					5.773.30
1.9. PUNET E ZDRUKTHETARISE					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Cmimi	Totali
	Furnizimi dhe montimi i dritareve prej materialit të plastikës me trashësi të profilin t=8.0cm me min. 5 komora (hapesira termike) dhe tre mbyllje gome. Plastika të jetë e perforuar me profil të çelikut (d=2mm) , adekuat për profilin e caktuar të PVC-së ngjyre antracide. Profili duhet të arrijë vlerat Uf prej 1.3 W/m2. Dritaret do të jenë me XHAM TE TREFISHIT 4+16+4+16+4 mm, Uw=0,8 ë.m-2K-1 mbushje me argon, Ug=0,6 ë.m-2K-1, izolimi akustik Rë-34 dB. Mekanizmi për hapje jo më lartë se 175 cm. Të aplikohet sistem katërshresor mbrojtës SIKKENS (apo të ngjajshme) me impregnim të thellë.				
1.9.1	Pos Dr 1 me dimensione 160*160 cm	copë	29.00	200.00 €	5,800.00
1.9.1	Pos 1' me dimensione 140*160 cm	copë	4.00	180.00 €	720.00
1.9.1	Pos 2 me dimensione 90*60 cm	copë	6.00	85.00 €	510.00
1.9.1	Pos 3 me dimensione 50*60 cm	copë	2.00	70.00 €	140.00
1.9.1	Pos 4 me dimensione 90*160 cm	copë	4.00	110.00 €	440.00
1.9.1	Pos 5 me dimensione 240*160 cm	copë	4.00	300.00 €	1,200.00
	Furnizimi dhe montimi i dyerve të brendshme me profile metalike dhe kapak nga druri i kualitetit të lartë. Profilet dhe mekanizmat montues dhe dorëz për hapje dhe mbyllje.				
1.9.6	Pos B me dimensione 90*210 cm	copë	11.00	175.00 €	1,925.00
1.9.8	Pos D me dimensione 180*210 cm	copë	2.00	15.00 €	30.00
1.9.8	Pos E me dimensione 100*210 cm	copë	2.00	170.00 €	340.00
	Furnizimi dhe montimi i derës të hyrja e kryesore, erembrojtësi dhe daljeve emergjente me mbi ndriqim, prej profileve të aluminit ngjyre antracide profil t=8.0cm me xham të trefisht 4+16+4+16+4 mm, Uë=0,8 ë.m-2K-1 mbushje me argon, Ug=0,6 ë.m-2K-1, izolimi akustik Rë-				
1.9.9	Pos A Me dimensione 180*260 cm	copë	2.00	700.00 €	1,400.00
1.9.9	Pos f Me dimensione 180*260 cm	copë	2.00	700.00 €	1,400.00
	Furnizimi dhe montimi i dyerve të Njyveve Sanitare nga PVC profilet. Profili me diameter të bazës Min. 8cm , me min. 5 komora (hapesira termike) dhe tre mbyllje gome. Plastika të jetë e lidhur me profil të çelikut adekuat për profilin e caktuar. Profili duhet të arrijë vlerat Uf prej 1.3 W/m2 . Panell thermopan dizajni i të ciles duhet të jetë i afert me projektin zbatues. Dyert duhet të ankorohen me bulona të galvanizuar .				
1.9.10	Pos C Me dimensione 80x210 cm	copë	8.00	135.00 €	1,080.00
	Furnizimi me material dhe montimi i derës nga metali për qasjen në hyrjen ekonomike-kaldatores me dimensione				
1.9.12	Pos D2 me dimensione 140*210 cm	copë	1.00	200.00 €	200.00
TOTALI POSICIONI:					15,185.00



1.10. PUNËT E GJETIT DHE FASADES					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.10.1	Furnizimi dhe ekzekutimi i gjetit të të gjitha mureve të brendshme dhe plafoni në dy shtresa (ketu nuk parashihen muret të nyjet sanitare), paraprakisht të behet përgaditja me lenden bazë, sipërfaqja duhet të jetë e lëmuar dhe gatshme për ngjyrosje.	m²	1542.30	2.00 €	3,084.60
1.10.2	Furnizimi dhe ekzekutimi i fasadës së jashtme termike demit (në llogari të merret rrejtë rëbë, llaq i plastifikuar dhe ngjyra) në niansë sipas përzgjedhjes së projektuesit ose investitorit.	m²	560.00	6.50 €	3,640.00
1.10.3	Furnizimi, transporti dhe punimi i cokles me shtresa perberse ngjites, rrejtë, kulir, dizajni sipas projektuesit ose investitorit.	m²	35.00	7.50 €	262.50
TOTALI POSICIONI:					6,987.10
1.11. PUNËT E NGJYROSJES					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.11.1	Furnizimi, transporti dhe ngjyrosja e mureve, të brendshme, plafonit dhe këthinave mbi bazament të gjetuar në objekt. Me polikolor në dy shtresa me nuanca të bardhë.	m²	1542.30	0.50 €	771.15
1.11.2	Furnizimi, transporti dhe lyerja e mureve të këthinave dhe koridoreve me ngjyrë të yndyrshme në lartësi h = 1.0 m'	m²	134.30	0.70 €	94.01
TOTALI POSICIONI:					865.16
1.12. PUNËT E QERAMIKËS DHE GRANITIT					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1.12.1	Furnizimi, transporti dhe mveshja e dyshemesë .në hapësirat e erembrojesit, koridoreve, kuzhines dhe hapësirat e administrates Me pllaka të granitit artificial në llaq të cementos, në hapësirat e paraqitura në projekt, dizajni sipas investitorit në llogari të merret edhe punimi i perimetrit h=10.0 cm	m²	251.70	17.00 €	4,278.90
1.12.2	Furnizimi, transporti dhe mveshja e mureve (sanitare) . Me pllaka të keramikës të kualitetit të lartë. Dizajni sipas investitorit	m²	292.00	13.00 €	3,796.00
1.12.3	Furnizimi, transporti dhe mveshja e dyshemeve (sanitare) . Me pllaka të keramikës të kualitetit të lartë. Dizajni sipas investitorit.	m²	62.00	13.00 €	806.00
1.12.4	Furnizimi, transporti dhe mveshja e dyshemesë me pllaka të keramikës (dyshemeja në hapësirë e kaldatores) me llaq të çimentos. Në llogari të merret edhe punimi i perimetrit h=10.0 cm	m²	13.60	13.00 €	176.80
1.12.5	Furnizimi, transporti dhe mveshja e shkalleve hyrse, rampes dhe pjesëve tjera hyrse në objekt me pllaka të granitit t=2cm jo rreshqitese. Dizajni sipas investitorit.	m²	24.90	45.00 €	1,120.50
TOTALI POSICIONI:					10,178.20
1.13. PUNËT E DYSHEMESË					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
113.1	Furnizimi i materialit dhe punimi i shtresës së estrikut në pllaken e dyshemes dhe kulmit me makinë me trashësi 5-7cm mbi bazën e përgatitur të shtresave izoluese strioportit t=4cm dhe shtresës hidroizoluese.	m²	784.30	4.50 €	3,529.35
1.13.2	Furnizimi dhe vendosja e dyshemesë me linoleumit në hapësirat e kalsave (në rrolne) lidhja behet me ngjites adekuat, në llogari të merret shtresa vetenivilizuese, ngjites adekuat, diktuni dhe shiriti rreth perimetrit të mureve në lartësi h=8 cm	m²	131.70	11.00 €	1,448.70
TOTALI POSICIONI:					4,978.05



1.14. PUNËT E PLLATOSE					
	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
